



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
FAKULTETI I BIZNESIT
DEPARTAMENTI I STATISTIKËS DHE INFORMATIKËS SË ZBATUAR

Nr. 227/5 Prot

Data: 12.05.26

VENDIM QARKULLUES DEPARTAMENTI

Nr.03, datë 12/05/2026

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në rregulloret e UAMD për programin e ciklit të tretë të studimit "Doktoraturë në Shkenca Ekonomike", Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar vendosi miratimin e kriterëve dhe të pikëzimit për vitin akademik 2025-2026, si vijon:

I. Kriteret e pranimit për kandidatët e doktoraturës.

- 1) Aplikanti për programin e studimit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, duhet të ketë përfunduar studimet Bachelor dhe/ose Master Shkencor në Shkenca Ekonomike, Informatikë Ekonomike ose të përafërta me to.
- 2) Aplikanti duhet të ketë përfunduar të dyja ciklet e studimit së bashku, (ose diplomë e integruar e nivelit të dytë, DIND), me notë mesatare të ponderuar 8 e lart.
- 3) Në rastet kur aplikanti ka mbi 10 vite akademike i angazhuar si lektor me kohë të plotë në procesin e mësimdhënies, kandidati përjashtohet nga kriteri i mesatares.
- 4) Në rastet kur aplikanti ka përfunduar studimet në një universitet të huaj diploma duhet të jetë e njohur dhe e konvertuar nga Ministria përkatëse për Arsimin.
- 5) Aplikanti duhet të ketë njohuri të thelluara teorike në profilin përkatës të shkencave ekonomike, Informatikës Ekonomike ose në fusha të përafërta.
- 6) Kandidati duhet të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtarisht në përputhje me udhëzimin përkatës të Ministrisë përgjegjëse për arsimin (Udhëzimit Nr. 52, datë 03.12.2015, i ndryshuar). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
- 7) Kandidatët konkurojnë me propozim për projekt individual kërkimor shkencor, të dakortësuar me Udhëheqësin Shkencor.
- 8) Kandidati dëshmon përkushtim dhe motivim të mjaftueshëm në realizimin e punës kërkimore shkencore të Doktoratës në Shkenca Ekonomike, të dëshmuar përmes planit kërkimor që dorëzon në dosjen e aplikimit.
- 9) Kandidati rekomandohet për të realizuar programin e Doktoratës të paktën nga 2 profesorë të cilët njohin eksperiencën akademike dhe kërkimore shkencore të kandidatit.
- 10) Kandidati duhet të ketë punë hulumtuese kërkimore shkencore në një nga fushat e

Shkencave Ekonomike, Informatika Ekonomike ose të përafërta me to.

- 11) Kandidati duhet të ketë eksperiencë jo më pak se 2 vite në mësimdhënie apo në kërkim shkencor në një institucion të Arsimit të Lartë, apo institucione të kërkimit bazë apo të zbatuar. Përrjashtohen nga ky kriter studentët e ekselencës.

II. Metodologjia e vlerësimit (Pikëzimi)

Tabela e pikëzimit për vlerësimin e dosjeve në Departamentin e Shkencave Ekonomike

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1) Diploma e fituar, kriteri (a) | <u>(maksimumi 400 pikë)</u> |
| i. Bachelor në Shkenca Ekonomike ose Informatikë e Zbatuar/Ekonomike | 200 pikë |
| ii. Master Shkencor në Shkenca Ekonomike ose Informatikë Ekonomike | 200 pikë |
| iii. Bachelor, programe të përafërta | 150 pikë |
| iv. Master Shkencor, programe të përafërta | 150 pikë |
| 2) Nota mesatare, kriteri (b) | <u>(maksimumi 250 pikë)</u> |
| i. 9.51 – 10.00 | 250 pikë |
| ii. 9.01 – 9.50 | 210 pikë |
| iii. 8.51 – 9.00 | 180 pikë |
| iv. 8.00 – 8.50 | 150 pikë |
| 3) Njohuri në gjuhë të huaja, kriteri (e) | <u>(maksimumi 200 pikë)</u> |
| i. Më shumë sesa një gjuhë e huaj | 200 pikë |
| ii. Një gjuhë e huaj | 150 pikë |
| 4) Pjesmarje në konferenca dhe revista shkencore, kriteri (j) | <u>(maksimumi 150 pikë)</u> |
| i. Më shumë sesa 2 | 150 pikë |
| ii. Deri në 2 | 100 pikë |

DREJTUESI I NJËSISË BAZË
Dr. Altin GJINI